



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA ELBASAN  
KESHILLI BASHKIAK I QYTETIT ELBASAN

Nr. 277 / Prot.

Date 26 .12. 2017

VENDIM

NR. 137 DATE 21 . 12. 2017

MBI

**“MIRATIMIN E BUXHETIT TE BASHKISE ELBASAN PER VITIN 2018”**

Ne mbeshtetje te ligjit nr.139/2015, date 17.12.2015 “Per veteqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, date 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqiperise”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, date 27.04.2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore”, ligjin nr.109/2017, date 30.11.2017 “Per buxhetin e vitit 2018”, pasi mori ne shqyrtim materialet “Mbi miratimin e buxhetit te Bashkise Elbasan per vitin 2018”, te pergatitura nga Bashkia e Qytetit Elbasan nepermjet drejtorive te saj, me propozim te Kryetarit te Bashkise Elbasan,

VENDOSI

1. Te miratoje buxhetin e vitit 2018 per Bashkine dhe institucionet vartese se saj, ne nivel programi, si me poshte dhe sipas pasqyrave e materialeve bashkelidhur :

1. Te ardhura gjithsej: 2,462,598 mije leke
2. Shpenzime gjithsej : 2,462,598 mije leke

2. Te miratoje kerkesat per projektet e investimeve per vitin 2018, me fondet e Zhvillimit te Rajoneve, sipas pasqyres bashkengjitur (tabela nr.9).

3. Te miratoje kalendarin e programit buxhetor afatmesem 2019-2021 dhe buxhetit vjetor 2019, bashkelidhur ketij vendimi.

4. Te miratoje listen e investimeve ne pritje, te cilat do te financohen ne rast te gjetjes se burimeve financiare (tabela nr.10).

5. Kontributi i Bashkise Elbasan per Keshillin e Qarkut per vitin 2018 eshte 1 % mbi te ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore.